



# PROPOZIMET PËR PROJEKT-KODIT CIVIL

## OPINION LIGJOR

**Shtator 2021**  
**Prishtinë**

## PËRMBAJTJA

1.	HYRJE .....	3
2.	NDRYSHIM-PLOTËSIMI I LIGJIT PËR FAMILJEN TË INTEGROHET NË KOD CIVIL.....	6
3.	TË RREGULLOHET NDARJA E TRUSTIT PENSIONAL DHE SIGURIME TJERA JETËSORE .....	14
4.	TË MOS LARGOHET NENI 54 NGA KODI CIVIL .....	15
5.	KONTRATA PARAMARTESORE DHE MARTESORE TË MOS PËRFSHIHEN NË KOD CIVIL.....	18
6.	TË RREGULLOHET GABIMI TEKNIK NGA NENI 305 (1431 NË KOD CIVIL) .....	19
7.	TË PLOTËSOHET NENI 330.....	20
8.	TË KRIJOHET INSTITUTI I PARADHËNIES PËR MBAJTJE FINANCIARE .....	21
9.	PROPOZIMET PËR NDRYSHIMET E KËRKUARA NË PROJEKT-KODIN CIVIL.....	22
	NENI 1169, VENDBANIMI, EKONOMIA FAMILJARE, PROFESIONI, PAR. 4.....	22
	NENI 1170 REGJIMI PASUROR NË MARTESË .....	22
	NENI 1172 PASURIA E PËRBASHKËT .....	23
	NENI 1183 (MARRËVESHJA PARAMARTESORE APO MARTESORE) TË LARGOHET.....	24
	NENI 54 (VLERËSIMI I PASURISË SË PËRBASHKËT NË RAST TË MOSMARRËVESHJES) TË PËRFSHIHET .....	24
	NENI 1431 SHTRIRJA E ALIMENTACIONIT .....	24
	NENI 1266 USHTRIMI I KUJDESIT NË RASTIN E NDARJES SË PRINDËRVE .....	25
	NENI 1453 MASAT E PËRKOQSHME EX-OFFICIO PËR MBAJTJEN E FËMIJËS.....	26
10.	KONKLuzion.....	27
11.	REFERENCAT .....	27

## 1. HYRJE

Ky opinion ligjor është përpiluar si argumentim në lidhje me dispozitat ligjore rreth ndarjes e pasurisë së përbashkët dhe mbajtjes financiare, por propozon edhe integrimin e instituteve të reja në Kod Civil.

INJECT në nëntor të vitit 2017 e ka inicuar ndryshim-plotësimin e Ligjit për Familjen për dispozitat rreth ndarjes së pasurisë së përbashkët dhe mbajtjes financiare, duke u bazuar në një analizë ligjore të thukët të Ligjit për Familje. *Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit* e ka pranuar kërkesën për inicimin e ndryshim-plotësimin dhe pas shqyrtimit të propozimeve, në rreth ekspertësh e ka hartuar ligjin për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Familjen, i cili është dërguar në Kuvend dhe është votuar unanimisht nga të gjithë deputetët e të gjitha partive politike dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2019.

Çuditërisht, Projekt-Kodi Civil, i dërguar në Kuvend në qershor të vitit 2020, nuk e ka integruar ndryshim-plotësimin e Ligjit për Familjen që kishte hyrë në fuqi, ishte pra ligj ekzistues. Ky opinion ligjor i kushton një vëmendje të veçantë dispozitave ligjore rreth ndarjes së pasurisë dhe alimentacionit në Projekt-Kodin Civil dhe e diskuton mospërfshirjen e ndryshim-plotësimin të Ligjit për Familjen të vitit 2019, duke i krahasuar dispozitat mes vete dhe duke dhënë sqarime rreth arsyeshmërisë ligjore të ndryshim-plotësimin të Ligjit për Familjen dhe dispozitave të Projekt-Kodit Civil.

Tutje, ky opinion ligjor, duke pasur parasysh avancimin e mbrojtjes ligjore të grave, të cilat në çdo shoqëri janë kategori më e cënueshme, e sidomos në Kosovë, ku punësimi i grave sillet rreth 13.7%, diskuton edhe çështje tjera që nuk janë rregulluar me Kodin Civil, siç janë ndarja e pensioneve dhe sigurimeve pas shkurorëzimit, instituti i paradhënies për nënat dhe fëmijët dhe obligimi për prindin kujdestar për të marrë autorizim për fëmijët nga ish-bashkëshorti.

Ky opinion ligjor është përgaditur për të shërbyer si dokument që do ta lehtësojë punën e grupit



punues të Projekt-Kodit Civil duke ofruar informata rreth menyrës së implementimit të ligjit në praktikën gjyqësore, informata të marra nga puna shumëvjeçare me hulumtime ligjore rreth vendimeve gjyqësore dhe nga krahasimi i legjislacioneve evropiane për çështjet në fjalë.

Qëllimi kryesor i këtij opinion ligjor është t'i shërbejë Ministrisë së Drejtësisë, deputetëve të Kuvendit dhe publikut të gjërë si informatë rreth çështjeve të kontestuara nga praktika gjyqësore në lidhje me temat e diskutuara.

Shpresojmë që grupi punues i Projekt-Kodit Civil t'i ketë parasysh propozimet tona, të cilat burojnë nga një punë shumëvjeçare dhe një përkushtim maksimal në krahasimin e legjislacioneve të ndryshme të vendeve evropiane. Shpresojmë poashtu që Ministria e Drejtësisë, deputetët dhe të gjithë akterët tjerë të involvuar në hartimin, procedimin dhe votimin e Projekt-Kodit Civil ta lexojnë këtë opinion ligjor dhe ta kenë parasysh se këto ndryshime do të rregullojnë si situatën e qytetarëve tanë para gjykatave, poashtu edhe punën e gjyqësorit.

Mbi të gjitha, duke ditur se produkti final i Projekt-Kodit Civil, me të gjitha arritjet, por edhe mangësitë eventuale, do të shihet si përgjegjësi e Ministrisë së Drejtësisë dhe Qeverisë, dhe jo e grupit punues apo projektit të financuar nga BE, atëherë interesi i Kosovës është që ky Kod Civil të jetë kualitativ dhe gjithëpërfshirës, duke mos lënë hapësira dhe dilema rreth dispozitave dhe spjegimeve të tyre.

Ministria e Drejtësisë i ka organizuar takimet e shoqërisë civile me grupin punues të Projekt-Kodit Civil, duke treguar një qasje bashkëpunuese dhe përkrahëse për shoqërinë civile dhe nevojat e qytetarëve të Kosovës. Fatkeqësisht, propozimet tona në kuadër të takimeve me grupin punues të Projekt-Kodit Civil gjatë diskutimeve janë refuzuar nga grupi punues, por pa dhënë ndonjë sqarim me shkrim në lidhje me refuzimin e propozimeve. Mendojmë se nuk do të duhej të vendoste grupi punues i Projekt-Kodit Civil për përfshirjen apo refuzimin e propozimeve të shoqërisë civile, por ajo do të duhej të bëhej nga një ekspert mbikëqyrës nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, një funksion që



do ta mbronte interesin e Ministrisë së Drejtësisë si përgjegjëse para shoqërisë kosovare dhe si arbiter mes kësaj të fund dhe grupit punues të Projekt-Kodit Civil, i cili është thjeshtë një projekt i jashtëm.

Fatkeqësisht, Projekt-Kodi Civil nuk jep sqarime rreth normave në Kod Civil, se prej cilit ligj burojnë, si është historiku i tyre, prej cilit model apo legjislacionit të cilit shtet janë marrë. Në këtë kontekst, është e vështirë të kuptohet pse janë refuzuar propozimet tona, të cilat kanë qenë të sqaruara dhe dokumentuara në mënyrë profesionale kur janë dërguar në Kuvend për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Familjen, dhe pse a priori nuk është integruar as ai ndryshim ligjor që ka hyrë në fuqi në vitin 2019 dhe as nuk janë përfillur kërkesat tona që Kodi Civil ta integrojë atë pjesë. Të paktën në lidhje me anashkalimin e ndryshim-plotësimin të Ligjit për Familjen, meqë ka qenë ligj ekzistues, grupi punues i Projekt-Kodit Civil do të duhej të jepte një sqarim me shkrim se pse nuk është integruar neni i ndryshuar 47 dhe neni i ndryshuar 305. Poashtu për nenin 54 që grupi punues e ka larguar duhet të jepet një shpjegim, se pse ai nen po kërkojka “vlerësimin e kontributeve” siç është bërë në praktikë gjyqësore dhe që ka qenë arsyeja që e kanë larguar nga Kodi Civil. Këto sqarime do të duhet të bëheshin për Ministrinë e Drejtësisë si përgjegjëse për Projekt-Kodin Civil dhe shoqërinë civile, si grup i interesit. Pa sqarimin me shkrim asnjëra palë nuk do të dimë cilat kanë qenë arsyet ligjore dhe motivet prapa ndryshimeve, largimeve, anashkalimeve të dispozitave në Kod Civil.

Në këtë kuptim, ky opinion ligjor, për temat të cilat i diskuton, ofron edhe sqarimin/spjegimin se prej ku janë marrë ato norma që diskutohen, prej cilit ligj dhe cilit vend. Poashtu jepet edhe sqarimin se pse kundërshtohet një interpretim i caktuar apo pse propozohet një normë e caktuar. Kjo e bën të mundur të përcillet argumenti ligjor në mënyrë transparente dhe të logjikshme, pa i lënë vend arbitraritetit dhe vendimmarrjes obskure apo edhe contra legem.

Në këtë kuptim, presim që këto propozime të integrohen në Projekt-Kod Civil, në të mirë të rregullimit ligjor dhe drejtësisë në vend.

## 2. NDRYSHIM-PLOTËSIMI I LIGJIT PËR FAMILJEN TË INTEGROHET NË KOD CIVIL

INJECT ka përcjellur me vemëndje punën e grupit punues të Projekt-Kodit Civil. Është e papranueshme mospërfshirja e ndryshimit të Ligjit për Familjen të votuar në Kuvend dhe në fuqi nga Janari 2019, në bazë të cilit puna me kujdesin ndaj fëmijëve dhe udhëheqjen e punëve të shtëpisë është konsideruar e barasvlefshme me punën me të ardhura të bashkëshortit të punësuar në nenin 47 (neni 1172 në Kodin Civil).

Ndryshimi i Ligjit për Familjen është kërkuar në bazë të hulumtimeve të shumta rreth vështirësive në praktikën gjyqësore dhe ka ofruar zgjidhjen më të lehtë për të bërë ndarjen e pasurisë së përbashkët bashkëshortore sipas dispozitave ligjore të Kosovës.

Sipas Ligjit për Familjen të Kosovës të vitit 2004, pasuria e përbashkët ndahet në pjesë të barabarta, pa marrë parasysh të ardhurat e njërit apo tjetrit bashkëshort. Në praktikën gjyqësore, në vendimet e gjykatave tona, në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatëse rreth ndarjes së pasurisë së përbashkët në Ligjin për Familjen, gjegjësisht nenet 47, 54 dhe 55, punës me kujdesin ndaj fëmijëve dhe udhëheqjen e punëve të shtëpisë i është përcaktuar vlera e një rroge minimale, duke shkelur në mënyrë flagrante dispozitat ligjore rreth ndarjes së pasurisë. Kjo është shkelje e ligjit dhe e të drejtave pronësore dhe pasurore të qytetarëve. Mbi të gjitha është obstrukcion ndaj arritjeve në fushën e drejtësisë dhe implementimit të drejtë të ligjeve, një prej kërkesave kryesore tash e sa herë edhe nga raportet e Bashkimit Evropian për Kosovën. Praktika gjyqësore, gjykatat tona, duke mos respektuar ligjet e Kosovës, vazhdimisht i kanë shkelur dispozitat ligjore gjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët dhe i kanë dëmtuar në shumicën dërmuese gratë. Të gjitha faktet për argumentet e lartpërmenduar<sup>1</sup> janë dërguar me shkrim në nëntor 2017 te Komisioni për Legjislacion, ku është marrë parasysh kërkesa për inicimin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Familjen dhe procedurat e mëtutjeshme me sukses kanë shpjerë deri te votimi në Kuvend i

---

<sup>1</sup> Iniciativa për Ndryshimin e Ligjit për Familjen, Luljeta Aliu (2017), <https://inject-ks.org/2019/09/09/ndryshimi-i-ligjit-per-familjen-autore-luljeta-aliu/>



ndryshimit të Ligjit për Familjen.<sup>2</sup>

Shteti i Kosovës vazhdon të pengohet në avancimin ekonomik dhe shoqëror dhe mbi të gjitha në avancimin e të drejtave të grave dhe të drejtave të njeriut, pikërisht për shkak të shkeljeve nga ana e gjyqësorit në çështjet e ndarjes së pasurisë dhe alimentacionit. Me këtë, gjyqësori njëkohësisht nuk po garanton qasje të drejtë në drejtësi për të gjithë qytetarët. Praktika gjyqësore në rastet e ndarjes së pasurisë dhe alimentacionit dëshmon gjithashtu se implementimi i ligjeve, një prej fushave më të kritikuara edhe nga raportet e BE-së për Kosovën, po pengohet edhe nga vetë gjykatat. Që gjykatat e Kosovës janë shkelësit më të mëdhenj të të drejtave të njeriut është dëshmuar edhe përmes raporteve të Avokatit të Popullit.<sup>3</sup>

Rreth mënyrës së ndarjes së pasurisë së përbashkët në praktikën gjyqësore të Kosovës, INJECT vazhdimisht ka publikuar hulumtime dhe ka avokuar për ndryshim-plotësimin e ligjit, por edhe të praktikës gjyqësore. Hulumtimet ligjore, të cilat janë bazuar në vendime gjyqësore të Gjykatës Themelore dhe të Apelit për rajonin e Prishtinës mund të gjenden në faqen e internetit të INJECT dhe të shihet mënyra e ndarjes së pasurisë në praktikë, ku edhe konstatohen dallimet mes dispozitave ligjore dhe praktikës gjyqësore.<sup>4</sup>

Diskriminimi institucional gjatë procedurave për ndarjen e pasurisë dhe alimentacionit i ka rrënjët thellë në një mendësi patriarkale, e cila gruan nuk mund ta paramendojë si pronare, por vetëm si pronë. Kjo mendësi patriarkale, fatkeqësisht frymon ende në shumicën e popullatës sonë. Përkundër që në gjyqësor kemi pasur përmirësime, fatkeqësisht një numër i madh i vetë gjyqtarëve dhe prokurorëve janë të ndikuar nga kjo mendësi. Për më tej, kësaj i shtohet shpeshherë edhe mungesa e vullnetit që në mënyrë të pavarur nga praktikat e gabuara gjyqësore, të marrin vetë në dorë dispozitat për t'i analizuar dhe për të marrë një vendim meritor, por vendimet merren në bazë të praktiva ekzistuese, të cilat kanë qenë të gabueshme. Një tjetër arsye për interpretimet e gabuara të

---

<sup>2</sup> Ndryshimi i Ligjit për Familjen, Gazeta Zyrtare, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18420>

<sup>3</sup> Avokati i Popullit, <https://www.oik-rks.org/2020/04/02/raporti-vjetor-2019/>

<sup>4</sup> Hulumtim ligjor rreth ndarjes së pasurisë së përbashkët dhe mbajtjes financiare – Ligji dhe Praktika Gjyqësore në Kosovë, <https://inject-ks.org/2021/06/22/hulumtim-ligjor-rreth-ndarjes-se-pasurise-se-perbashket-dhe-mbajtjes-financiare-ligji-dhe-praktika-gjyqesore-ne-kosove/>



dispozitave kanë qenë edhe hapësirat ligjore, të cilat kanë lënë vend për hamendësime. Shqetësimet e përmendura më lart kanë qenë arsyeja e propozimit për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Familjen.

Projekt-Kodi Civil, në verzionin e fundit, edhe pas shumë diskutimesh të thirrura nga Ministria e Drejtësisë, përkundër insistimit të INJECT, nuk e ka përfshirë ndryshimin e Ligjit për Familjen. Ky ndryshim-plotësim e kishte pamundësuar keqinterpretimin e ligjit në lidhje me parimin e qasjes së barabartë, në pjesë të barabarta në pasurinë e përbashkët, siç ka qenë e paraparë në bazë të dispozitave 47, 54 dhe 55, por që në praktikë gjyqësore vazhdimisht janë shkelur. Ndryshim/plotësimi i Ligjit për Familjen nuk e ka ndryshuar ligjin si të tillë, por vetëm e ka pamundësuar që ligji të interpretohet në mënyrë të gabuar, duke e plotësuar dhe saktësuar në frymën ekzistuese të ligjit. Baza për ndarjen e barabartë të pasurisë së përbashkët ka qenë gjithmonë në Ligjin për Familjen, por në praktikë dispozitat janë keqinterpretuar për shkak ta disa hapësirave të vogla ligjore, të cilat pastaj natyrisht janë përdorur, qoftë nga mungesa e aftësisë interpretuese, qoftë nga mungesa e vullnetit që gratë të kenë qasje në gjysmën e pasurisë, apo edhe thjeshtë nga pamundësia të konceptohet se grave vërtetë ju takon gjysma e pasurisë në bazë të kontributit të dhënë në shtëpi si amvise. Ndryshim-plotësimi i Ligjit për Familjen, në mënyrë decidive dhe të pakontestueshme e ka qartësuar mënyrën e ndarjes së pasurisë në pjesë të barabarta, duke përcaktuar në nenin 47 se

1. *Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me kontribut të përbashkët gjatë vazhimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë.*
2. *Kontribut i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhimit të martesës konsiderohet:*
  - a. *të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort;*
  - b. *ndihma e bashkëshortit e afruar bashkëshortit tjetër, siç është kujdesi për fëmijët, udhëheqja e punëve të shtëpisë, përkujdesja dhe mirëmbajtja e pasurisë, si dhe çfarëdo forme tjetër e punës dhe e bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.*
3. *Kontributi i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhimit të martesës për fitimin e pasurisë së përbashkët konsiderohet i barasvlershëm.*





4. *Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët, nëse nuk janë marrë vesh ndryshe.*
5. *Pasuria e bashkëshortëve e fituar bashkërisht përmes lojërave të fatit konsiderohet pasuri e përbashkët.*
6. *Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve mund të përfshijë të drejtat sendore dhe të detyrimeve.*

Më ndryshim-plotësimin e vitit 2019, në paragrafin 1 të nenit 47 është përcaktuar se pasuria e përbashkët është pasuria e fituar me kontribut të përbashkët. Më herët, ky paragraf ka përcaktuar se pasuria e përbashkët krijohet punë. Pra, ndryshim-plotësimi e larguar fjalën “punë” dhe e ka zëvendësuar atë me fjalën “kontribut”. Arsyet për këtë ndryshim burojnë nga fakti që Ligji për Familjen, *per se*, nuk ka bërë dallim mes këtyre dy fjalëve, por i ka njejtësuar ato për nga vlera që kanë për krijimin dhe shtimin e pasurisë së përbashkët. Këtë njejtësim ligji e ka bërë në dispozitën e nenit 54, ku përcaktohet

1. *Nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në **kontributin e bashkëshortëve**, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe **jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër**, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.*
2. *Gjykata kompetente vendos po ashtu në rast të mosmarrëveshjes lidhur me pjesët e pasurisë së bashkëshortëve të paraparë sipas këtij neni.*

Në nenin 54 shihet se fjala kontribut është përdorur edhe për kontributin material përmes të hyrave monetare në formë të rrogës nga puna jashtë shtëpisë dhe në formë të të hyrave tjera, **POR EDHE për KONTRIBUTIN JO-MATERIAL në formë të ndihmës “si kujdesin për fëmijët,**



**udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.”**

Fatkeqësisht, në praktikën gjyqësore, nuk është marrë parasysh dhe nuk është aplikuar drejtë as dispozita nga neni 47, as kjo nga neni 54. Në nenin 47, para ndryshim-plotësimit të Ligjit për Familjen, ka qenë e përcaktuar se “pasuria e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e krijuar me punë”. Për këtë arsye, në praktikën gjyqësore dispozita është aplikuar asisoji që pasuria e krijuar gjatë martesës t’i takonte vetëm personit që ka punuar jashtë shtëpisë dhe ka pasur të hyra monetare. Kësisoji, puna e amvisërisë, kontributi jo-material, nuk është konsideruar si pjesë që ka pasur një vlerë për krijimin dhe shtimin e pasurisë, përkundër që në nenin 54, në pjesën ku thuhet **“ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët”** decidivisht është përcaktuar se këto forma të punës në shtëpi dhe amvisëri kontribuojnë në shtimin e pasurisë së përbashkët.

Ndryshim-plotësimi i Ligjit për Familjen, duke u nisur nga hulumtimi disamujor që i është kushtuar Ligjit për Familjen paraprakisht, me shumë kujdes i ka analizuar këto detaje dhe me shumë të drejtë e ka zëvendësuar fjalën “punë” në nenin 47 me fjalën “kontribut”. Qëllimi ka qenë që të mos ketë dilema në praktikë gjyqësore mes këtyre dy fjalëve, pra të kuptohet se edhe puna me të hyra, por edhe kontributi jo-material i garantojnë të drejtën qytetarëve në gjysmën e pasurisë së përbashkët, siç edhe ka qenë gjithmonë e përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 47, ku është thënë se “bashkëshortët janë pronarë të barabartë, në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët”, nëse nuk janë marrë vesh ndryshe. Zëvendësimi i fjalës “punë” me fjalën “kontribut” nuk e dëmton bashkëshortin e punësuar, por e ndihmon evitimin e diskriminimit të bashkëshortit të papunësuar jashtë shtëpisë. Diskriminimi në gjykata për bashkëshortin e papunësuar ka ndodhur pikërisht për shkak se kontributi jo-material me fëmijë, punë të shtëpisë etj. nuk është shikuar sikur të ketë vlerën e njëjtë për shtimin e pasurisë si puna me rrogë dhe



me të hyra. Mirëpo me dispozitat e Ligjit për Familjen janë njejtësuar format e ndryshme të kontributit në nenin 54, për ta argumentuar dispozitën në nenin 47 ku përcaktohet se pasuria e përbashkët ndahet në pjesë të barabarta.

Pra, neni 47, i vjetri, në paragrafin 1, thotë se pasuria e përbashkët është krijuar me punë, por ligji nuk e bën dallimin mes fjalës “punë” dhe fjalës “kontribut”. Në paragrafin 4 thuhet se bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët. Zbërthimi i paragrafit 4, pra arsyetimi se pse bashkëshortët janë pronarë në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët bëhet pikërisht në nenin 54, ku format e ndryshme të kontributeve, pra “puna” dhe “kontributi” në amvisëri, njejtësohen, barazohen dhe përcaktohen si të vlerës së njejtë, sepse në nenin 54, paragrafin 1 thuhet se, nëse nuk ka marrëveshje paraprake rreth ndarjes së pasurisë, gjykata e vendosë ndarjen e pasurisë dhe “Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave”, pra nuk duhet të kuptohen vetëm rroga dhe të hyrat si kontribut për krijimin dhe shtimin e pasurisë, por edhe kontributi jo-material.

Për ta ndryshuar qasjen në praktikën gjyqësore ndaj termit “kontribut”, me qëllim që të ngulitet në kokën e shoqërisë se kontributi jo-material nuk duhet të kuptohet si më pak i vlefshëm për krijimin e pasurisë së përbashkët, dhe për ta evituar diskriminimin gjatë ndarjes së pasurisë për shkak të këtij termi, i cili edhe në gjyqësor është trajtuar sikur të mos kishte vlerën e njejtë si kontributi me rrogë gjatë ndarjes së pasurisë, pra për këto arsye, ndryshim-plotësimi e ka zëvendësuar fjalën “punë” me fjalën “kontribut”, sepse edhe brenda ligjit ato kanë qenë sinonime.

Ndryshim-plotësimi i Ligjit për Familjen, përpos zëvendësimit të fjalës “punë” me fjalën “kontribut” në paragrafin 1, për ta bërë sa më kompakte dispozitën dhe për ta lehtësuar punën e praktikës gjyqësore, në paragrafin 2 e ka përcaktuar cilat janë format e kontributeve:



*2. Kontribut i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhdimit të martesës konsiderohet:*

- a. të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort;*
- b. ndihma e bashkëshortit e afruar bashkëshortit tjetër, siç është kujdesi për fëmijët, udhëheqja e punëve të shtëpisë, përkujdesja dhe mirëmbajtja e pasurisë, si dhe çfarëdo forme tjetër e punës dhe e bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.*

Ky ndryshim e ka kompletuar dispozitën në kuptim të asaj se çka konsiderohet si kontribut. Kjo pjesë është marrë nga neni 54, ku këto forma të kontributit kanë qenë të përshkruara në paragrafin 1.

Për ta siguruar që nuk do të ketë hamendësime, dilema apo paqartësi, ndryshim-plotësimi i Ligjit për Familjen, në paragrafin 3 të nenit 47 ka përcaktuar se *“kontributi i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhdimit të martesës për fitimin e pasurisë së përbashkët konsiderohet i barasvlershëm.”* Me këto intervenime përmes ndryshim-plotësimit të Ligjit për Familjen në nenin 47, është siguruar që nuk do të ketë më aplikim të padrejtë në praktikën gjyqësore.

Projekt-Kodi Civil, në verzionin e propozuar, në vend se ta integronte këtë pjesë, duke e anashkaluar ndryshimin e Ligjit për Familjen të 2019, e legalizon prapë mundësinë e diskriminimit në praktikë gjyqësore, sepse i len hapësirat ligjore që kanë ekzistuar para ndryshim-plotësimit të vitit 2019. Përkundër obligimit profesional dhe etik që ta përfshijnë, meqë ka qenë ligj ekzistues, i votuar nga të gjithë deputetët e pranishëm në Kuvend dhe përkundër që Kuvendi është instanca ligjvënëse, grupi punues i Kodit Civil lehtësisht e ka injoruar faktin se ndryshim-plotësimi i Ligjit për Familjen është votuar nga deputetët dhe si i tillë detyrimisht është dashur të përfshihet në Kod Civil.

Përkundër që anëtarët e grupit punues kanë deklaruar se e kanë rregulluar qasjen e barabartë në pjesë të barabarta në pasurinë e përbashkët, grupi punues i Projekt-Kodit Civil nuk ka ndryshuar



asgjë substanciale në nenin 47 (1172), por e ka lënë siç ka qenë më herët para ndryshimit të Ligjit për Familjen të vitit 2019. Kërkojmë që ndryshimi i Ligjit për Familjen i 2019 të përfshihet.

Arsyetimi për mospërfshirjen e ndryshimit të nenit 47 në Kod Civil nga grupi punues gjatë takimeve me shoqërinë civile ka qenë se duhet të kenë parasysh harmoninë ligjore. Ky argument nuk qëndron, sepse neni 47 i ndryshuar me ndryshim-plotësimin e Ligjit për Familjen është në harmoni absolute me dispozitat tjera relevante në nenin 54 dhe nenin 55 në lidhje me ndarjen e pasurisë e përbashkët. Qëndrimi se dispozita e atij neni nuk është në harmoni me dispozitat tjera rrjedh nga interpretimi i gabuar i nenit 54, i cili pa të drejtë dispozitën e nenit 54, paragrafi 1 e ka interpretuar asisoi që ka bërë valorizimin e kontributit jo-material duke i caktuar një vlerë të rrogës minimale, përkundër që ajo dispozitë nuk është dashur kurrë të interpretohet asisoi. Në fakt, neni i ndryshuar 47 është në harmoni të plotë me nenet tjera, por është praktika gjyqësore ajo që nuk ka qenë dhe nuk është ende në harmoni me dispozitat nga këto nene të ligjit.

Argumenti tjetër nga grupi punues i Projekt-Kodit Civil ishte se pjesa e shtjellimit të formave të ndryshme të kontributeve gjendet në nenet tjera dhe nuk ka nevojë të përsëritet në nenin 47. Meqë ka pasur kaq shumë paqartësi në lidhje me ndarjen e pasurisë së përbashkët, më mirë do të ishte të përsëritet një normë, sesa të mbetet e paqartësuar. Ligji për Familjen, në rastin e përcaktimit të mbajtjes financiare për shembull, e përsërit normën e njejtë në nenin 286, në nenin 305 dhe nenin 330, duke përcaktuar në të tri këto nene se vëllimi i mbajtjes financiare (ushqimisë dhe alimentacionit) bëhet në përputhje dhe konform standardit jetësor në martesë, pra që është progresiv sipas kushteve që kanë ekzistuar gjatë martesës. Edhe pse kjo normë ka qenë tri herë e përsëritur, prapë në praktikë gjyqësore nuk ka gjetur zbatim. Pra, ligji nuk e ndalon përsëritjen e një norme, aq më pak kur ajo bëhet në favor të kuptimit dhe zbatimit më të lehtë të ligjit. Neni 47, ku flitet për pasurinë e përbashkët, meqë sqaron se çka përbën pasuri të përbashkët, detyrimisht duhet edhe të përmbajë sqarimin se çka përcaktohet si kontribut dhe si qëndrojnë format e ndryshme të kontributit në raport me pjesën e pasurisë së përbashkët. Kjo do ta ndihmonte edhe gjyqësorin, sepse pjesët kyçe do të ishin të sqaruara në një nen të vetëm dhe gjyqtarët nuk do të detyrohen që



të interpretojnë në mënyrë arbitrare apo edhe të konzultojnë disa nene të ndryshme. Ne e dimë se shpeshherë nenet nuk janë aplikuar edhe pse kanë qenë shumë të rëndësishme për mënyrën se në çfarë pjesë duhet të bëhet pjesëtimi i pasurisë së përbashkët. Rasti më eklatant i neglizhimt absolut të një dispozite ligjore është anashkalimi komplet i nenit 55, i cili titullohet “Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët”. Ky nen përcakton se vetëm ai bashkëshort që ka një pasuri të veçantë të caktuar, ka të drejtë të kërkojë që pjesa e tij nga pasuria e përbashkët të jetë me e madhe në përputhje me pasurinë e veçantë. Rrjedhimisht, nenet në lidhje me ndarjen e pasurisë së përbashkët duhet të jenë sa më kompakte dhe gjithpërfshirëse. Prandaj edhe duhet të integrohet neni 47 ashtu siç ka qenë i votuar në Kuvend dhe ka hyrë në fuqi në 2019, para se Projekt-Kodi Civil ka filluar ta trajtojë pjesën e pasurisë së përbashkët.

### **3. TË RREGULLOHET NDARJA E TRUSTIT PENSIONAL DHE SIGURIME TJERA JETËSORE**

Propozojmë poashtu që si pasuri e përbashkët të llogariten edhe trusti dhe sigurimet pensionale, siç bëhet edhe në vendet evropiane. Ligji e ka rregulluar se të hyrat konsiderohen të përbashkëta, pra nuk i takojnë vetëm bashkëshortit që ka punuar me pagë, por në rast të ndarjes, pasuria ndahet në pjesë të barabarta. Në mënyrë analoge, edhe trusti pensional, që është derivat nga të hyrat, duhet të ndahet në pjesë të barabarta në momentin e ndarjes së bashkëshortëve. Kjo është e rregulluar kështu edhe në vendet evropiane, pra nuk është zbulim kosovar. Dhe gjithsesi herët apo vonë, ky ndryshim do të kërkohet të bëhet. Falë balancimit/pjesëtimit të kontributeve pensionale dhe sigurimeve tjera për moshën, bashkëshorti që kujdeset për fëmijët dhe nuk ka mundur të punojë apo nuk ka mundur të punojë me përqindje të plotë nuk do të dëmtohet në krahasim me bashkëshortin me të ardhura më të mëdha. Prandaj, meqë jemi duke e hartuar Kodin Civil, pse duhet t’i vonojmë ndryshimet që e përmirësojnë jetën e qytetarëve, e që në rastet më të shpeshta janë gratë apo që po dëmtohen ekonomikisht dhe që gjendja e tyre e rënduar ekonomike po i detyron që ato të qëndrojnë në një marrëdhënie abuzive dhe të rrezikojnë edhe jetën e tyre. Meqë po pretendojmë se po krijojmë në Kod Civil modern, duke e shtuar edhe institutin e kontratës paramartesore/ martesore, atëherë duhet të jemi modern për të gjithë, e jo në mënyrë selektive në përfitim të njëjës gjini e në dëm të tjetrës. Kodi Civil gjerman (Bürgerliches Gesetzbuch)



e ka të rregulluar në nenin 1587 që nga viti 1977 pjesëtimin e trustit pensional, sigurimit jetësor dhe sigurimeve tjera eventuale.<sup>5</sup> Zvicra e ka rregulluar pjesëtimin e pjesës së pensionit dhe sigurimeve në vitin 2000 në nenet 122 deri neni 126.<sup>6</sup> Për të mos e ngarkuar këtë opinion ligjor me shembuj tjerë, vetëm duhet të theksohet se shumica e vendeve perëndimore e kanë të rregulluar me ligj balancimin/pjesëtimin e pensionit dhe sigurimeve jetësore. Propozojmë që rregullimi bazë të futet në Kod Civil me një afat 3 vjeçar të fazës kalimtare, gjatë së cilës do të përpilohen udhëzimet e sakta se çka dhe si duhet ndarë dhe në çfarë mënyre. Mendojmë se futja tani në Kod Civil do të kontribuonte që kjo pjesë vërtetë të rregullohet brenda një afati të caktuar prej tre vitesh.

#### 4. TË MOS LARGOHET NENI 54 NGA KODI CIVIL

Projekt-Kodi Civil e ka larguar nenin 54 të Ligjit për Familjen, i cili ishte neni i vetëm në të gjithë ligjin, ku puna me kujdesin ndaj fëmijëve dhe mirëmbajtjen e shtëpisë konsiderohej si e vlerës së barabartë me të ardhurat dhe si shtim i pasurisë. Arsyeja gjatë debateve me grupin punues ishte se neni 54 ka përcaktuar se duhet të vlerësohen kontributet, në kuptimin se kontributet duhet të valorizohen, duke ia caktuar pra një vlerë monetare kontributit jo-material. Është e vërtetë se në praktikë gjyqësore ky nen është aplikuar asisoji, gabimisht, por pa të drejtë. Dispozita e nenit 54 në asnjë pjesë nuk e përcakton se duhet të bëhet një valorizim monetar i kontributit jo-material. Përkundrazi, neni 54 thjeshtë e jep qartësimin pse bashkëshortët janë pronarë të barabartë në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët, duke i njejtësuar kontributet me përcaktimin se

---

<sup>5</sup> “§ 1587 Verweis auf das Versorgungsausgleichsgesetz: Nach Maßgabe des Versorgungsausgleichsgesetzes findet zwischen den geschiedenen Ehegatten ein Ausgleich von im In- oder Ausland bestehenden Anrechten statt, insbesondere aus der gesetzlichen Rentenversicherung, aus anderen Regelsicherungssystemen wie der Beamtenversorgung oder der berufsständischen Versorgung, aus der betrieblichen Altersversorgung oder aus der privaten Alters- und Invaliditätssvorsorge.” PËRKTHIMI NË ANGLISHT “Section 1587, Reference to the Pension Equalisation Act [Versorgungsausgleichsgesetz]: In accordance with the Pension Equalisation Act, an equalisation takes place between the divorced spouses of rights existing in Germany or elsewhere, in particular of the statutory pensions insurance, from other standard security systems such as civil servants pensions or pensions of a professional group, from company pensions or from private old-age and invalidity pensions.”, <https://www.buergerliches-gesetzbuch.info/bgb/1587.html>

<sup>6</sup> Kodi Civil Zvicëran, [https://www.fedlex.admin.ch/eli/cc/24/233\\_245\\_233/de#a90](https://www.fedlex.admin.ch/eli/cc/24/233_245_233/de#a90)



“Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes **vlerësimit të të gjitha rrethanave**”, e jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat por edhe kontributin jo-material.

Neni 54 asnjëherë nuk flet për “vlerësim të kontributeve” në kuptimin se kontributet duhet monetarizuar ose që gjykata ka të drejtë kontributit jo-material t’ia caktojë një vlerë monetare siç bëhet në praktikën gjyqësore. Termi “vlerësim i kontributit” nuk ekziston në asnjë pjesë të ligjit. Ky nen është aplikuar gabimisht, është interpretuar gabimisht. Por kjo nuk është arsye që neni të largohet. Çfarë duhet bërë është të ngriten kapacitetet e gjyqësorit, duke e qartësuar se si duhet interpretuar neni 54 në ndërlidhje me nenin 47 dhe nenin 55. Dispozitat ligjore në lidhje me çfarëdo çështje duhet të interpretohen në mënyrë sistematike, holistike dhe integrative, e jo të shihet neni si i izoluar. Kjo është njëra arsye pse neni 54 nuk duhet larguar.

Arsyeja tjetër pse largimi i këtij neni nuk duhet të bëhet, është fakti se vetëm ky nen e përcakton se nëse nuk ka marrëveshje paraprake rreth ndarjes së pasurisë, vendimi për ndarjen e pasurisë merret nga gjykata.

Ndërsa arsyeja kryesore dhe vendimtare është se me largimin e nenit 54 po bëhet mohimi i së drejtës për qasjen në pasuri për të gjithë qytetarët që momentalisht kanë lëndët e tyre aktive nëpër gjykata. Nëse largohet ky nen, atëherë në gjykata do të thuhet se për lëndët para hyrjes në fuqi të Kodit Civil vlen ligji i atëhershëm, pra Ligji për Familjen i vitit 2006, dhe se ai ligj ka përcaktuar se kontributet duhet të vlerësohen monetarisht dhe se në praktikë gjyqësore kontributi i amvisërisë është përcaktuar të këtë vlerën e rrogës minimale të Kosovës. Ne nuk guxojmë të lejojmë që kjo të ndodhë, sepse me plot vetëdije do të dëmtonim qytetarët e Kosovës. Neni 54 është aplikuar gabimisht deri më tani. Asnjëherë nuk ka pasur të drejtë gjykata apo dikush tjetër që kontributit jo-material, amvisërisë, t’ia caktojë një vlerë monetare. Sipas Ligjit për Familjen sigurisht që jo, sepse nuk ka asnjë kriter apo parametër se si do të duhej të bëhej një gjë e tillë në një rënë anë, dhe në anën tjetër ligji në nenin 47 shumë qartë e ka thënë se bashkëshortët janë pronarë të barabartë në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët e në nenin 55 e ka përcaktuar se një pjesë më të madhe (që i bie më shumë se gjysma, nëse e kemi parasysh nenin 47, paragrafi 4) mund të kërkojë njëri bashkëshort vetëm në rastin kur ka pasuri të veçantë që ka qenë pjesë e





pasurisë së përbashkët. Tjetër gjë është nëse në praktikë gjyqësore ligji nuk është aplikuar drejtë. Ligji ka qenë gjithmonë në rregull, dhe neni 54 asnjëherë, në asnjë pjesë nuk e legjitimon të bëhet dallimi mes kontributit material dhe atij jo-material. Por në praktikë gjyqësore është vepruar ndryshe. Kjo, megjithatë nuk nënkupton se duhet larguar neni 54, por që duhet të punohet me gjyqësorin në ngritjen e kapaciteteve dhe të ketë udhëzime nga Këshilli Gjyqësor dhe nga Gjykata Supreme se si duhet interpretuar dispozitat në lidhje me ndarjen e pasurisë së përbashkët.

Nëse largohet neni 54, në po ia pamundësojmë qytetarëve që janë në procese gjyqësore që para Gjykatës Supreme të atakojnë vendimet gjyqësore të cilat nuk e kanë bërë ndarjen e pasurisë në pjesë të barabarta, por që kanë kërkuar ekspertizë financiare për caktimin e vlerës së punës së papaguar në formë të amvisërisë. Kjo do të ishte një padrejtësi e madhe, e papranueshme, që qytetarëve të ju mohohet e drejta e tyre. Një punë shumë më vlefshme dhe lehtësim si për gjykatat, poashtu edhe për qytetarët do të ishte qartësimi dhe udhëzimi se si duhet interpretuar neni 54. Kodi Civil e ka mundësinë që në pjesën ku jepen qartësimet apo arsyetimet e normave, të sqarojë se neni 54 është interpretuar gabimisht dhe të japë udhëzimin se si duhet kuptuar ky nen. Me këtë vërtetë do të bëhej revolucion, sepse të gjithë qytetarët që janë nëpër procese gjyqësore do të shpëtonin nga zvarritja disavjeçare, nga ngarkesa financiare për procedurat dhe nga lodhja dërrmuese e pritjes për zgjidhje të rasteve. Lëndët e ndarjes së pasurisë janë vonuar kryesisht për shkak se praktika gjyqësore nuk ka ditur si ta interpretojë nenin 54, e ka interpretuar gabimisht se duhet të bëhet një valorizim i punës së papaguar në shtëpi, dhe pastaj me vite ka zgjatur procedura, sepse palët janë munduar të ofrojnë dëshmi, kanë bërë manipulime gjatë procedurave dhe kryesisht gratë janë dëmtuar sepse ato kanë qenë amvise dhe puna e tyre është vlerësuar me rrogë minimale. Natyrisht këto lëndë kanë shkuar në Apel për tu rishikuar, por që edhe aty nuk e kanë gjetur zgjidhjen e merituar sipas ligjit, sepse edhe në Apel është interpretuar gabimisht neni 54.

Kështu që neni 54 nuk duhet të largohet, por Kodi Civil duhet ta qartësojë në pjesën e arsyetimit të normës se si duhet të interpretohet ky nen. Kjo do të ishte puna më e mirë dhe ndihma më e madhe për qytetarët dhe gjyqësorin që Kodi Civil do të mund ta bënte.



## 5. KONTRATA PARAMARTESORE DHE MARTESORE TË MOS PËRFSHIHEN NË KOD CIVIL

Projekt-Kodi Civil e ka shtuar një nen të ri, nenin 1170, i cili e shton institutin e kontratës paramartesore dhe martesore në ligj. Ky nen përcakton se me marrëveshje paramartesore, pra para martesës, ose me marrëveshje martesore kurdoqoftë gjatë martesës, bashkëshortët të mund të nënshkruajnë një kontratë në lidhje me çështjet pasurore dhe të vendosin për administrimin e tyre pasuror në të ardhmen. Kjo formë e kontratës martesore e lehtëson diskriminimin dhe presionin mbi gratë nga ana e burrave. Sidomos kur ato janë me fëmijë dhe nuk janë në marrëdhënie pune shkak i përkujdesjes ndaj fëmijëve, gratë janë të detyruara të pranojnë çfarëdolloj kontrate, vetëm sa për të mos e rrezikuar divorcin dhe rrezikimin e humbjes së çatisë mbi kokë. Ky nen është jashtëzakonisht i dëmshëm. Mbi të gjitha është i panevojshëm, sepse Ligji për Familjen e njeh institutin e pasurisë së veçantë (neni 46 LFK), që nënkupton se pasuria që dikush e ka pasur paraprakisht para martesës mbetet e tij edhe pas divorcit. Poashtu, Ligji për Familjen në nenin 53 e parasheh mundësinë e ndarjes së pasurisë edhe gjatë martesës, por natyrisht sipas parimeve të ligjit, gjë që siguron ndarje korrekte. Ndërsa kontrata para/martesore nuk bën detyrimisht ndarje korrekte sipas ligjit, por ndarje sipas marrëveshjes mes palëve. Çfarë është krijuar me kontratën paramartesore dhe martesore është thjesht një mekanizëm shtesë për ta siguruar mundësinë e shtypjes ndaj grave përmes situatës së privilegjuar të burrit ndaj gruas para dhe gjatë martesës. Grupi punues i Kodit Civil ka argumentuar se kontrata para/martesore nuk guxon të bëhet në kundërshtim me dispozitat rreth ndarjes së pasurisë, por është e pakuptueshme se si do të garantohet që kjo nuk ndodhë. Nëse është menduar që kjo të bëhet sipas ligjit, atëherë çfarë dallimi ka instituti i kontratës para/martesore nga neni 53? Është shumë e sigurtë që në rrethanat dhe mentalitetin që ne jetojmë, me mungesën e njohurive ligjore të qytetarëve, me vetëm 13.7 % të grave të punësuara dhe me mentalitetin patriarkal që mbisundon, që kontrata para/martesore do të shfrytëzohet për ta siguruar epërsinë e bashkëshortit më të fortë ekonomikisht. Çfarë arsye tjetër përpos kësaj mund të ketë ky institut i kontratës para/martesore? Nëse mendohet se kjo bëhet për ta futur në pjesën e pasurisë së përbashkët edhe pasurinë e veçantë, atëherë ky institut nuk është fare i nevojshëm, sepse ajo mund të bëhet edhe pa këtë



institut, thjeshtë me shprehjen e vullnetit së bashkëshortëve. Nëse mendohet që instituti të mbrojë pasurinë e veçantë, prapë nuk është i nevojshëm ky institut, sepse pasuria e veçantë është e rregulluar me ligj. Nëse mendohet të rregullohet ndarja e pasurisë gjatë martesës, ky institut nuk nevojitet për atë punë, sepse neni 53 e ka rregulluar tashmë. Thjeshtë, ky institut, në nivelin e zhvillimit shoqëror ku ne jemi si Kosovë, më shumë krijon dëme se që rregullon diçka. Prandaj ne jemi kundër dhe propozojmë që të mos krijohet instituti i kontratës para/martesore.

## **6, TË RREGULLOHET GABIMI TEKNIK NGA NENI 305 (1431 NË KOD CIVIL)**

Projekt-Kodi Civil nuk e ka korigjuar gabimin teknik nga Ligji për Familjen në nenin 305 (neni 1431 i Kodit Civil), i cili ishte korigjuar me ndryshimin e Ligjit të vitit 2019. Ky nen duhet të ndryshohet duke e përfshirë korigjimin e bërë në vitin 2019 me NDRYSHIM/PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR FAMILJEN. Tutje, neni 305 duhet të plotësohet për të përcaktuar periudhën relevante për vlerësimin e standardit jetësor në martesë. Kjo për arsye se në shumë raste, pasi të inicohet urdhërbrojtje apo kërkesë për shkurorëzim, ish-bashkëshortë abuzues dhe të papërgjegjshëm e ndryshojnë statusin e tyre financiar duke ndryshuar të ardhurat me qëllim të dëmtimit të palës tjetër. Është e papranueshme të lejohet që gjatë procedurave gjyqësore të ndryshohen të ardhurat drastikisht, vetëm për arsye të ikjes nga përgjegjësia për sigurimin e alimentacionit për nënën dhe fëmijët. Prandaj, në nenin 305 duhet të bëhet përcaktimi se **standardi jetësor në martesë llogaritet sipas gjendjes materiale që ka ekzistuar deri në momentin e inicimit të procedurave për kërkesën e mbajtjes financiare dhe alimentacionit**, sepse në praktikë vërtetimi i gjendjes faktike po bazohet në gjendjen momentale kur gjyqtari e merr lëndën dhe me raste madje bazohet në gjendjen para marrjes së vendimit gjyqësor, që nënkupton se ka kaluar një periudhë kohore pas inicimit të procedurave dhe gjatë kësaj kohe i padituri ka pasur mundësi të ndryshimit të qëllimshëm të të ardhurave dhe të gjendjes faktike.

Standardi jetësor gjatë martesës dhe vëllimi i mbajtjes dhe alimentacionit duhet të përcaktohet



sipas nenit 330 të Ligjit për Familjen të Kosovës<sup>7</sup>, ku qartazi shihet se ligji nuk ka lënë hapësirë për manipulime, sepse e ka theksuar se përcaktimi bëhet sipas të gjitha mjeteve (ku përfshihet edhe pasuria, prona etj.), dhe jo vetëm sipas të ardhurave.

## 7. TË PLOTËSOHET NENI 330

Neni 330 duhet të plotësohet duke përcaktuar se në raste të ndryshimeve të të hyrave dhe gjendjes faktike financiare të bashkëshortëve gjatë procedurave gjyqësore, gjykatat duhet të kërkojnë dëshmi mjekësore, të marrin pasqyrat financiare përmes detyrës zyrtare nga Banka Qendrore e Kosovës dhe informatat rreth pronave nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe të bëjnë një ekspertizë të thellë hetimore në lidhje me arsyet e ndryshimit të të ardhurave dhe nëse vërtetohet ndryshimi i qëllimshëm i të ardhurave dhe gjendjes faktike financiare, atëherë kjo nënkupton vepër penale dhe dënohet sipas Kodit Penal, dispozitave për mashtrim dhe deklaram të rrejshëm.

Poashtu, në bazë të shqetësimeve në praktikë gjyqësore rreth keqpërdorimit nga persona të dhunshëm, propozojmë që neni 139 (1266 në Kod Civil) (Ushtrimi i kujdesit në rastin e ndarjes së prindërve) të plotësohet. Kjo për arsye se në rastet e ndarjeve për shkak të dhunës, pala e dhunshme edhe pas shkurorëzimit zakonisht tenton që me çdo formë ta vështirësojë jetën e palës tjetër, duke keqpërdorur si mjet shpeshherë edhe fëmijët. Në rast të udhëtimeve jashtë vendit të njërit prind të shkurorëzuar, në kufi kërkohet një autorizim me nënshkrim të të dy prindërve. Në rastet e ndarjeve për shkak të dhunës, kjo keqpërdoret, duke vazhduar dhunën psikologjike përmes mosdhënies së nënshkrimit për udhëtim për prindin kujdestar dhe fëmijën. Por me që prindi kujdestar e ka kujdestarinë e fëmijëve, nuk duhet të lejohet që e drejta e tij të kufizohet nga ish-bashkëshorti i dhunshëm. Propozojmë që të mos ketë detyrim të autorizimit për udhëtim në

---

<sup>7</sup> NENI 330 Parimet e përcaktimit të mbajtjes dhe alimentacionit (LFK)

(1) Detyrimi për të dhënë mbajtje financiare ose alimentacion përcaktohet në proporcion me të gjitha mjetet e të paditurit dhe brenda kufijve të nevojave të paditësit.

(2) Gjykata duhet të ketë parasysh gjendjen financiare të të paditurit, aftësinë për të punuar, mundësinë faktike për punësim, kushtet shëndetësore, nevojat personale, detyrimet ligjore dhe të gjitha kushtet tjera relevante.

(3) Kur alimentacioni kërkohet për fëmiju, gjykata merr parasysh moshën e fëmijut dhe të gjitha nevojat për edukim dhe arsimim.



rastet kur ka shkurorëzimi ka ndodhur për shkak të dhunës në familje.

## **8. TË KRIJOHET INSTITUTI I PARADHËNIES PËR MBAJTJE FINANCIARE**

Neni 327 (1453 në Kod Civil) (Masat e përkohshme ex-officio për mbajtjen e fëmijës) duhet të ndryshohet për të përfshirë edhe masa të përkohshme ex-officio për mbajtjen financiare të ish-bashkëshortit/es. Propozojmë që ky nen të titullohet «Paradhënia për mbajtje financiare», duke krijuar njëkohësisht institutin e ri ligjor të paradhënies për mbajtje financiare në legjislacionin tonë. Ky nen të përfshijë paradhënien për mbajtjen financiare si për ish-bashkëshortin/en, poashtu edhe për fëmijët, e cila do të paguhet nga institucionet shtetërore, në rastet kur ish-bashkëshorti/ja i/e obliguar për mbajtje financiare nuk i përmbushë apo nuk ka mundësi të përmbushë vendimet e gjykatës për këtë. Shuma e paradhënies për mbajtje financiare duhet të llogaritet si një borxh ndaj shtetit i bashkëshortit që ka detyrimin të ofrojë mbajtje financiare. Paradhënia në këtë formë ekziston në legjislacionet e vendeve evropiane. Paradhënia për të ofruar mbajtje financiare të përkohshme parimisht të bëhet sipas standardit jetësor në martesë, e jo sipas skemave sociale. Paradhënia për fëmijën duhet të paguhet nga shteti pa marrë parasysh të ardhurat e prindit kujdestar.

### **Në vazhdim, për lexim më të lehtë të propozimeve, teksti është i shkruar në dy ngjyra.**

- Ngjyra e zezë vlen për tekstin e neneve nga Projekt-Kodi Civil.
- Në ngjyrë të kuqe janë shkruar propozimet e INJECT.

## 9. PROPOZIMET PËR NDRYSHIMET E KËRKUARA NË PROJEKT-KODIN CIVIL

### **Neni 1169, Vendbanimi, ekonomia familjare, profesioni, par. 4.**

4. Bashkëshortët martesorë bashkërisht kontribuojnë në mirëmbajtjen e familjes në përpjestim me aftësitë e tyre individuale. Kontribut i përbashkët i bashkëshortëve konsiderohet si udhëheqja e ekonomisë familjare ashtu edhe fitimet tjera të nevojshme për jetën e familjes dhe prezumohet se ata janë pjesmarrës të barabartë me kontributet e tyre në shpenzimet familjare.
  4. Bashkëshortët bashkërisht kontribuojnë në mirëmbajtjen e familjes. Vlera e punës me kujdesin për fëmijët dhe udhëheqjen e punëve të shtëpisë konsiderohet e barasvlefshme me punën e paguar me të ardhura personale dhe të hyra të tjera të bashkëshortit të punësuar. Bashkëshortët prezumohet se janë pjesëmarrës të barabartë në mirëmbajtjen e familjes.
- 

### **Neni 1170 Regjimi pasuror në martesë**

...

3. Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve martesorë është pasuria e fituar me punën e tyre të përbashkët ose të ndarë, gjatë vazhdimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë nëse me kontratë paramartesore bashkëshortët martesorë nuk kanë përcaktuar regjimin pasuror të pasurisë së fituar gjatë martesës.
4. Bashkëshortët martesorë me kontratë të veçantë në çdo kohë gjatë jetës së tyre të përbashkët martesore mund t'i rregullojnë çështjet pasurore dhe të vendosin për regjimin dhe administrimin e tyre pasuror.
5. Pa një marrëveshje të tillë dhe për aq sa nuk ka marrëveshje të bërë sipas nenit 1183, atëherë zbatohen nenet vijuese.

## **NENI 1170**

3. Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë.
  4. *paragrafi 4 të largohet i tëri.*
- 

## **Neni 1172 Pasuria e përbashkët**

1. Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë të përbashkët ose të ndarë gjatë kohëzgjatjes së martesës, si edhe të hyrat që rrjedhin nga çfarëdo mënyre tjetër nga pasuria e përbashkët;
2. Pasuria e përbashkët mund të përfshijë gjithashtu të drejtat sendore dhe të drejtat e detyrimeve (kërkesave);
3. Pasuria e fituar me lojërat e fatit, nga dhuratat e përbashkëta, nga pronësia intelektuale, dhe format tjera të ngjashme, gjatë kohëzgjatjes së martesës konsiderohet pasuri e përbashkët.
4. Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse nuk kanë marrëveshje paramartesore apo martesore.

## **Neni 1172**

### **Pasuria e përbashkët**

1. Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me kontribut të përbashkët gjatë vazhdimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë.
2. Kontribut i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhdimit të martesës konsiderohet:
  - 2.1 të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort;
  - 2.2 ndihma e bashkëshortit e afruar bashkëshortit tjetër, siç është kujdesi për fëmijët, udhëheqja e punëve të shtëpisë, përkujdesja dhe mirëmbajtja e pasurisë, si dhe çfarëdo forme tjetër e punës dhe e bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.



3. Kontributi i përbashkët i bashkëshortëve gjatë vazhimit të martesës për fitimin e pasurisë së përbashkët konsiderohet i barasvlershëm.
  4. Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët, nëse nuk janë marrë vesh ndryshe.
  5. Pasuria e bashkëshortëve e fituar bashkërisht përmes lojërave të fatit konsiderohet pasuri e përbashkët.
  6. Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve përfshin **kontributet pensionale dhe sigurimet jetësore**, të drejtat sendore dhe të detyrimeve.
- 

### **NENI 1183 (Marrëveshja paramartesore apo martesore) të largohet**

### **NENI 54 (Vlerësimi i pasurisë së përbashkët në rast të mosmarrëveshjes) të përfshihet**

#### **Neni 54. Vlerësimi i pasurisë së përbashkët në rast të mosmarrëveshjes**

1. Nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe **jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.**
  2. Gjykata kompetente vendos po ashtu në rast të mosmarrëveshjes lidhur me pjesët e pasurisë së bashkëshortëve të paraparë sipas këtij neni.
- 

### **Neni 1431 Shtrirja e alimentacionit**

Vëllimi i alimentacionit varet nga standardi jetësor në martesë. Mbajtja e gjendjes së jetesës kërkon gjithashtu shpenzime për sigurim të përshtatshëm shëndetësor dhe shpenzimet për arsimim të mëtejshëm apo rikualifikim në përputhje me nenin 1432, *paragrafin 3, të këtij libri.*



## **Neni 1431**

### **Shtrirja e alimentacionit**

1. Vëllimi i alimentacionit varet nga standardi jetësor në martesë para inicimit të kërkesës për mbajtje financiare dhe alimentacion. Mbajtja e gjendjes së jetesës kërkon gjithashtu shpenzime për sigurim të përshtatshëm shëndetësor, shpenzimet për arsimim të mëtejshëm apo rikualifikim në përputhje me nenin 1432.
2. Vëllimi i alimentacionit duhet përcaktohet në përputhje me nenin 1456 (Parimet e përcaktimit të mbajtjes financiare dhe alimentacionit).
3. Në rast të zvogëlimit të të ardhurave, gjendjes financiare faktike apo pronësore të të paditurit pas inicimit të procedurave gjyqësore, gjykata ex officio duhet të kërkojë vërtetim të ekspertizës mjeko-ligjore, pasqyrat bankare nga Banka Qendrore për llogaritë bankare të të paditurit dhe të verifikojë pronat në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

---

## **Neni 1266 Ushtrimi i kujdesit në rastin e ndarjes së prindërve**

1. Nëse prindërit jetojnë ndaras, kujdesin prindëror e ushtron prindi me të cilin jeton fëmija nëse me këtë pajtohet prindi tjetër.
2. Nëse në rastin e jetës së ndarë prindërit nuk merren vesh se me cilin prej tyre do të jetojë fëmija, vendimin lidhur me këtë gjë e merr gjykata kompetente, nëse me këtë libër nuk është caktuar ndryshe.
3. Në rastet kur prindërit jetojnë të ndarë, janë të shkurorëzuar ose martesa e tyre është e anuluar me vendim të gjykatës ose të organit tjetër kompetent, dhe fëmija i është besuar për ruajtje dhe edukim njërit prind, kujdesin prindëror e ushtron prindi të cilit i është besuar fëmija.
4. Gjatë kohës së ekzekutimit të masës gjyqësore, kujdesin prindëror e ushtron prindi të cilit me aktvendim i është urdhëruar të zbatojë masën.

### **[këtij neni i shtohet edhe një paragraf 5 si në vijim]**

5. Në rastet kur prindërit janë shkurorëzuar për shkak të dhunës në familje, prindi i cili e ushtron kujdesin prindëror sipas vendimit të gjykatës, mund të udhëtojë me fëmijë jashtë vendit pa autorizimin e prindit tjetër.

---

### **Neni 1453 Masat e përkohshme ex-officio për mbajtjen e fëmijës**

1. Në kontestet për mbajtje financiare të fëmijëve, në kontestet për kujdestarinë dhe në kontestet ku mbajtja financiare e fëmijës vendoset ex officio, gjykata përcakton ex officio masa të përkohshme për mbajtje financiare nëse të dy prindërit nuk kontribuojnë efektivisht në mbajtjen financiare të fëmijës.
2. Nëse prindi i cili mbi bazë të vendimit të gjykatës është i detyruar të ofrojë shumën e përcaktuar për mbajtje financiare, nuk i kryen detyrimet e tij rregullisht, Organi i Kujdestarisë në bazë të kërkesës së prindit tjetër apo si pjesë e detyrës së tij zyrtare ndërmerr të gjitha masat e domosdoshme për t'i ofruar fëmijës mbajtje financiare të përkohshme në përputhje me dispozitat mbi mbrojtjen sociale të fëmijëve.
3. Masa duhet të zgjasë për aq sa prindi i nuk i përmbush detyrimet e tij.
4. Ndaj këtij prindi do të inicohet zbatimi i masave nëse kjo është e domosdoshme.

### **Neni 1453 Paradhënia për mbajtjen financiare**

1. Në kontestet për mbajtje financiare, për kujdestarinë dhe në kontestet ku mbajtja financiare vendoset ex officio, gjykata mund të përcaktojë ex officio masën e përkohshme të paradhënies për mbajtje financiare për ish-bashkëshortin/en dhe alimentacionin.
2. Paradhënia përcaktohet nga gjykata në rastet kur prindi, i cili mbi bazë të vendimit të gjykatës është i detyruar të ofrojë shumën e përcaktuar për mbajtje financiare, nuk i kryen apo nuk ka mundësi t'i kryej obligimet e tij.
3. Paradhënia për mbajtje financiare të përkohshme të bëhet sipas standardit jetësor në martesë.
4. Paradhënia për fëmijën duhet të paguhet nga shteti pa marrë parasysh të ardhurat e prindit kujdestar.

## 10. KONKLUZION

Sipas elaborimit më lart, konsiderojmë se votimi i Projekt-Kodit Civil do të jetë i dëmshëm për gratë dhe fëmijët, nëse nuk mirren parasysh propozimet e dërguara në vijim. Si organizatë e shoqërisë civile, e cila është angazhuar me vite dhe specifikisht për këtë pjesë të Ligjit për Familjen, shpresojmë që propozimet tona të merren parasysh.

Kemi besim të madh në bashkëpunimin konstruktiv mes akterëve me qëllim të rregullimit ligjor të çështjeve të rëndësishme për jetën e qytetarëve, siç janë propozimet që kemi bërë më lart.

Apelojmë te grupi punues i Projekt-Kodit Civil që propozimet tona t'i shqyrtojë me kujdes dhe me vëmendje, sepse janë çështje me të cilat përballen një numër i madh i qytetarëve, për të cilat këto rregullime do të kenë rëndësi të veçantë, sepse mirëqenia e tyre varet nga to. Sidomos kur numri më i madh i tyre janë gratë dhe fëmijët, dy grupe të cënueshme dhe më të pambrojtura të shoqërisë.

## 11. REFERENCAT

- Luljeta Aliu 2017, Iniciativa për Ndryshimin e Ligjit për Familjen
- Ligji për Familjen i Kosovës
- Projekt-Kodi Civil i Kosovës
- Ndryshimi i Ligjit për Familjen i Kosovës
- Hulumtimi ligjor rreth ndarjes së pasurisë së përbashkët dhe alimentacionit – Ligji dhe Praktika Gjyqësore në Kosovë